



## REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA FINANSUE - MINISTRY OF FINANCE  
Njësia për Inteligjencë Financiare - Finansijska Obaveštajna Jedinica  
Financial Intelligence Unit  
Nr./Br. FIUAD: 172/2019 Nr./br.str. -5  
Data/Datum 22/08/2019  
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

### NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr. 03/ L -149, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Njësia për Inteligjencë Financiare shpallë:

### KONKURS TË BRENDSHËM (AVANCIM)

#### I. SEKTORI I OPERATIVËS DHE ANALIZËS

Pozita (1 pozitë):	Udhëheqës i Sektorit të Operativës dhe Analizës
Referenca:	001-08-2019 /NjIF-K
Grada e vendit punës:	/
Koeficienti:	808.70 euro bruto
I përgjegjet:	Drejtorit të NjIF-K
Vendi:	Prishtinë

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon kërkimin, marrjen, analizimin, dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente informacionet në lidhje me dyshimin për pastrimin e parave, luftimin e financimit të terrorizmit dhe veprave të ndërlidhura penale;
- Menaxhon dhe mbikëqyrë përzgjedhjen e rasteve që janë me prioritet për analizim dhe bënë shpërndarjen e tyre;
- Zhvillon metodat dhe proceset e punës për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut për PPP/LFT;
- Koordinon detyrat e Sektorit të Operativës dhe Analizës me Sektoret tjera përkatëse përbrenda funksioneve të NjIF-K si dhe çështjet operative të ndërlidhura me Institucioneve të tjera si; Policinë, Prokurorinë, Doganat, Administratën Tatimor të Kosovës, etj;
- Analizon, përpunon dhe i klasifikon informatat e siguruar për punën e NjIF-K;
- Analizon dhe përpunon të dhënat që gjenerohen brenda sistemit të NjIF-K dhe institucioneve tjera, pastaj rekomandon sipas rezultateve të analizave shpërndarjen tek

autoritetet kompetente;

- Bashkëpunon me Sektorët e tjera në NjIF-K, në kuadër të përmbushjes sa më optimale të detyrave të përbashkëta të përcaktuara në planin vjetor të punës; Kryen detyra tjera të parapara me Ligj për PPP/LFT dhe akte tjera normative siç autorizohet nga Drejtori i NjIF-K;

### Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:

- Diplomë universitare apo të avancuar në Fakultetin Ekonomik, Juridik apo të ngjashme;
- Minimumi katër (4) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e operativës dhe analizave financiare;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrjen efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemit;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve;
- Njohja e gjuhës shqipe apo serbe si dhe angleze;

## II. SEKTORI PËR ÇËSHTJE LIGJORE DHE BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

<b>Pozita (1pozitë):</b>	Udhëheqësi i Sektorit për Çështje Ligjore dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>Referenca:</b>	002-08-2019 /NjIF-K
<b>Grada e vendit punës:</b>	/
<b>Koeficienti:</b>	808.70 euro bruto
<b>I përgjigjet:</b>	Drejtorit të NjIF-K
<b>Vendi:</b>	Prishtinë

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron mbështetje ligjore në hartimin e dokumenteve strategjike dhe legislative nga fushëveprimi i NjIF-së;
- Ofron ndihmë në hartimin e legjislacionit parësor dhe dytësor nga fushëveprimi i NjIF-së;
- Siguron respektimin e teknikave dhe standardeve të hartimit të legjislacionit nga fushëveprimi i NjIF-së;
- Siguron përafrimin e legjislacionit të NjIF-së me legjislacionin e Bashkimit Evropian (acquis communautaire) si dhe me ligjet e aplikueshme në Kosovë;
- Ofron këshilla ligjore dhe rekomandime nga fushëveprimi i NjIF-së sipas kërkesës;
- Bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë për përfaqësimin e NjIF-së në kontestet gjyqësore;

### Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkathtësitet tjera:

- Diplomë universitare apo të avancuar në Fakultetin Juridik;
- Minimumi katër (4) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në çështjet ligjore dhe bashkëpunim ndërkombëtar;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrjen efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës , përfshirë zgjidhjen e problemit;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve;
- Njohja e gjuhës shqipe apo serbe si dhe angleze;

### III. SEKTORI PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE ADMINISTRIMIT TË BAZES SË TË DHËNAVE

<b>Pozita (1 pozitë):</b>	<b>Udhëheqës i Sektori për Teknologji Informative dhe Administrim të Bazës së të Dhënave</b>
<b>Referenca:</b>	<b>003-08-2019 /NjIF-K</b>
<b>Grada e vendit punës:</b>	<b>/</b>
<b>Koeficienti:</b>	<b>808.70 euro bruto</b>
<b>I përgjigjet:</b>	<b>Drejtorit të NjIF-K</b>
<b>Vendi:</b>	<b>Prishtinë</b>

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon të gjitha sistemet dhe nënsistemet e Teknologjisë Informative dhe komunikimeve (TIK) në kuadër të Njesisë për Inteligjencë Financiare dhe ofron shërbimet dhe përkrahje për të gjithë shfrytëzuesit e sistemeve dhe pajisjeve të TI-së;
- Harton dhe zbaton planet strategjike afatshkurtra dhe afatgjata për të siguruar kapacitetet e sistemit si tërësi që t'i plotësojë kërkesat aktuale dhe ato në të ardhmen;
- Dizajnon dhe zhvillon sistemet softuerike dhe implementon ato në infrastrukturën teknike të TIK-ut;
- Siguron subjektet raportuese se sistemet informative funksionojnë konform kërkesave dhe procedurave ligjore në fuqi;
- Zhvillon strategjinë dhe planet e punës së TI-së për përmbushjen e objektivave të Njesisë për Inteligjencë Financiare;
- Identifikon dhe menaxhon riskun në sistemin informativ dhe planifikon dhe menaxhon planet strategjike të kthimit të sistemeve në rast të fatkeqësive të mundshme;
- Siguron përmbushjen e standardeve të funksionimit dhe sigurisë së sistemit të TI-së në NjIF-K për pajisjet dhe shfrytëzuesit në NjIF-K;
- Siguron që menaxhmenti i NjIF-K kur merr vendime që kanë të bëjnë edhe me TI-në të jenë konform trendëve në zhvillim, të sigurojnë vazhdueshmëri dhe qëndrueshmëri në relacion me proceset e TI-së dhe siguron se projektet e TI-së dhe infrastrukturës janë

përfunduar brenda buxhetit dhe në kohë, si dhe me cilësi të kërkuara;

- Përkrah personelin në sistemin e TI-së në NjIF-K, përcjelljen e performancës së tyre, identifikimi i aftësive dhe mangësive dhe organizimi i trajnimeve përkatëse;
- Bashkëpunon me Sektoret e tjera në NjIF-K, në kuadër të përmbushjes sa më optimale të detyrave të përbashkëta të përcaktuara në planin vjetor të punës;
- Kryen detyra tjera të parapara me Ligj për PPP/LFT dhe akte tjera normative siç autorizohet nga Drejtori i NjIF-K;
- Kryen detyra tjera të parapara me Ligj për PPP/LFT dhe akte tjera normative siç autorizohet nga Drejtori i NjIF-K dhe/ose udhëheqësi i drejtpërdrejtë tij/saj.

#### **Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:**

- Diplomë universitare apo të avancuar në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Teknologjisë Informative ose të ngjashme,
- Minimumi katër (4) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e teknologjisë informative;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrjen efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës , përfshirë zgjidhjen e problemit;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve;
- Njohja e gjuhës shqipe apo serbe si dhe angleze;

**Shënim:** Procedura e konkurimit është e hapur për nëpunësit ekzistues në Njësinë për Inteligjencë Financiare të cilët i plotësojnë kriteret e Konkursit për avancim. Njësia për Inteligjencë Financiare ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë të punësuarit ekzistues brenda NjIF-K. Rekrutimi dhe Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karriere të Nëpunësve Civile.

*“Njësia për Inteligjencë Financiare, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.*

*“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrorë dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”*

Marrja dhe dorëzimi i Aplikacioneve: Njësia për Inteligjencë Financiare, zyra nr.6/ « Rr. Eduard Lir Nr.194 – Arbëri – Pristina Kosovë

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni NjIF-K, tel: 038 - 247 105, prej orës 08:00 – 16:00.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, Dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), Dëshminë e përvojës së punës dhe dokumentet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Konkursi është i hapur 8 ditë** nga dita e publikimit në web – faqen e Njesisë për Inteligjencë Financiare dhe Tabelën e Shpalljeve në NjIF-K, duke filluar nga data 22.08.2019 deri me datën 30.08.2019 në orën 16:00 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së Konkursit.